Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 399/01
Datë 06.11.2015

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 06.11.2015 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin dhe ri akreditimin si dhe validimin dhe ri validimin e Qendrës për Aftësim Profesional Ferizaj për periudhën: 06.11.2015 deri 06.11.2018 për të ofruar këto kualifikime:

1.1. Instalues i Ngrohjes Qendrore, niveli 3 i KKK;

Akreditimi dhe validimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Masat e sigurisë për të gjithë kandidatet obliguese për gjatë gjithë kohës së trajnimit këpucët e sigurisë se punës helmetës dhe pajisjeve tjera të nevojshme.
- Të montohet një ventilator për pastrimin e kabinetit gjatë përdorimit te bombolës për lidhjet salduara i cili do të ndihmoj në largimin e gazit të liruar.
- Mungon lista e materialit shpenzues, duhet të jetë lista e materialit shpenzues i cili nuk mund të përdoret më tutje.
- Të vendoset shenja për dalje emergjente.

(Afati kohor i këtyre kushteve: 01.10.2016)

1.2. Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit, niveli 3 i KKK

Akreditimi dhe validimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të merren masat e sigurisë për të gjithë kandidatet, obliguese për gjatë gjithë kohës së trajnimit (përdorimi i këpucëve të sigurisë së punës dhe përdorimi i helmetës).
- Të montohet një ventilator për pastrimin e kabinetit gjatë përdorimit të bombolës për lidhjet salduara i cili do te ndihmoj në largimin e gazit te liruar.
- Mungon lista e materialit shpenzues, duhet të jetë lista e materialit shpenzues i cili nuk mund të përdoret më tutje.
- Të vendoset shenja për dalje emergjente

  (Afati kohor i këtyre kushteve: 01.10.2016)

1.3. Teknologji Informative dhe e Komunikimit, niveli 2 i KKK;

Akreditimi dhe validimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Kompjuterët kanë të instaluar sistemin operativ Windows 7 dhe paketën e aplikacioneve të MS Office 2010 të pa licencuar. Ka edhe kompjuter që kanë të instaluar dy sisteme operative në formatin dual boot me Windows XP/Windows 7. Rekomandohet që sistemi operativ dhe pako e aplikacionit të MS Office të jenë të licencuar.
- Kandidatët janë në nivele të ndryshme dhe është paksa e papërshtatshme që trajneri në të njëjtën orë të merret me grupe të ndryshme të kandidatëve, ku një kandidat është në modulin e parë, një tjetër në të tretin e kështu me radhë. Rekomandohet që nëse është e mundur grupi të jetë prej grupi sa ma homogjen duke krijuar grupe që janë në modulin e njëjtë.
- Edhe përkundër orarit të përshtatshëm, fondit të mjaftueshëm të orëve si dhe përkushtimit maksimal të trajnerit, mbajtja e provimeve në formatet me shkrim dhe praktik duket se vë ngarkesë të padëshiruar tek kandidatët duke qenë se ata/ato mësojnë teknologjinë informative për zbatim praktik. Rekomandohet që të shqyrtohen mundësitë që testet/provimet të mbahen vetëm në pjesën praktike.
- QRAP ka trajnuar dhe vazhdon të trajnojë një numër të konsiderueshëm të kandidatëve dhe nuk ekziston ndonjë bazë e të dhënave e mirëfilltë. Rekomandohet që të krijohet një bazë e strukturuar e të dhënave që do të mundësonte ruajtjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave të kandidatëve në mënyrë shumë më të mirë dhe efikase.
- Edhe përkundër faktit që kandidatit i ofrohet edukimi profesional në fushën e teknologjisë informative ashtu që ai/ajo të shtojë mundësitë e gjetjes së punës, çalon komunikimi i QRAP me bizneset meqë kjo është përgjegjësi e QRP (Qendrës Rajonale

për Punësim). Rekomandohet që të shtohet ky komunikim me qellim të rritjes së mundësisë së punësimit të kandidatit/tes.

- QRAP posedon dhomë të serverit por nuk posedon: intranet e as ueb sajt te vetin! Rekomandohet që të kenë një hapësirë në kuadër të faqes së MPMS dhe të mund të administrojnë vetë, ose edhe të kenë një faqe të përbashkët për të gjitha qendrat.
- Meqë QRAP është një vatër e mirëfilltë edukative ku merren njohuri profesionale, kandidatët nuk dallohen nga nëpunësit e organizatës. Kjo vë në pah faktin që medoemos duhet të vendoset një standard në identifikimin e nëpunësve nga kandidatët dhe të tjerët, si edhe kërkohet që kandidatët të nënshkruhen në listën e vijueshmërisë për aq kohë sa zgjat trajnimi.
- Komunikimi i zyrtarëve të qendrës me organizata dhe persona të ndryshëm realizohet në masë edhe përmes postës elektronike private. Rekomandohet që stafi i QRAP të përdorin e-Postën zyrtare për komunikim elektronik të brendshëm dhe të jashtëm.
- Trajneri bënë punën e trajnerit dhe të zyrtarit të cilësisë. Edhe pse kanë vizita nga DAP për vlerësim të cilësisë, rekomandohet që QRAP të posedon staf të veçantë për sigurim të cilësisë.
- Aktualisht QRAP nuk kanë të drejtë të kenë më shumë se një trajner. Në mungesë të trajnerit, angazhohet kandidati/tja më i/e për zëvendësim. Rekomandohet që QRAP të ketë dy trajner të TIK.
- Literatura është përditësuar gjatë pranverës së këtij viti (2015), porse nuk i jepet kandidatit jashtë objektit të QRAP. Meqë mbetet përgjegjësi e kandidatit të siguroj literaturën për përdorim të përhershëm, rekomandohet që të shqyrtohen mundësitë e ofrimit të literaturës në formatin elektronik.
- Ka raste kur kandidatët e ndërpresin trajnimin dhe nuk e vijojnë më, gjë që QRAP nuk mban shënim se përse ndodh një gjë e tillë. Rekomandohet që të vendoset një sistem i cili mban komunikimin me kandidatin për kohën sa vijon trajnimin si edhe pasi të mbaron trajnimin deri në punësimin e tij/saj.
- Mirëmbajtja teknike e kompjuterëve, pajisjeve periferike dhe e pajisjeve të rrjetit është e centralizuar nga MPMS. Rekomandohet që mirëmbajtja teknike të ofrohet nga QRAP.
- Salla e kompjuterëve ka 16 kompjuter për nevoja të kandidatëve, një kompjuter për nevoja të trajnerit, një kompjuter për punë praktike, një projektor, një panel për projektim dhe një tabelë pune. Në sallë vërehet që ka rrjet të hapësirës lokale (LAN) porse jo të gjithë kompjuterët janë të lidhur në rrjet (Internet). Rekomandohet që të gjithë kompjuterët të lidhen në rrjet funksional përmes të cilit rrjet kandidatët të kenë qasje në Internet ashtu që të përmbushin kërkesat e moduleve të trajnimit.
- Çdo fund vit përpilohen planet e zhvillimit për të gjithë trajnerët në DAP dhe aty përcaktohet më pastaj ecuria e zhvillimit profesional. Trajneri është certifikuar me shpenzime personale dhe në një masë edhe nga donacioni i LUX. Rekomandohet që të alokohet buxhet i posaçëm për zhvillimin profesional të trajnerit.

- Rekomandohet që QRAP të definojë procedurat se si do të kërkojë nga DAP trajnimin dhe ricertifikimin e trajnerëve. Duke pas parasysh se DAP nuk ofron certifikime nga ana e fushës së TI, rekomandojmë që QRAP të inicioje kërkesat më herët në DAP (jo në fund të viti por në gjysmën e parë të vitit) në mënyrë që DAP këto kërkesa ti procedojë te MPMS. Po rekomandojmë që QRAP të koordinohet me IKAP (Institutin Kombëtar për Administratë Publike) që vepron në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, pasi që aty ofrohen trajnime edhe nga fusha e TI. Duke pas parasysh faktin se shumica e certifikimeve të TI kanë vlefshmëri për 3 vite (për shembull Cisco) dhe se versionet e softuerëve ndryshojnë QRAP duhet që ricertifikim e trajnerëve ta ketë si pjesë të procesit të punës.
- Detyra të shtëpisë nuk kanë kandidatët. Çdo modul ka një detyrë e cila realizohet në klasë. Rekomandohet që të përpilohen detyra të shtëpisë ashtu që kandidati të jetë aktiv me procesin e mësimit për aq kohë sa zgjat trajnimi.
- Në formatin ekzistues të trajnimit QRAP nuk e ka të përfshirë praktikën në mjedis të biznesit. Ndaj duke parë disponimin e kandidatëve te cilët favorizojnë mundësinë qe krahas trajnimit ne qendër te kenë mundësinë edhe te mbajtjes se praktikës se paku një javore ne ndonjë institucion publik do te ishte e mirë se ardhur qe menaxhmenti te diskutoje këtë mundësi me personelin kompetent në MPMS.
- Pas përfundimit të kursit trajnerët përgatisin dosjen komplete të kandidatit ku përfshihen rezultatet në të gjitha modulet e arritura. Certifikata e nënshkruar dhe e protokolluar i dorëzohet kandidatit. Rekomandohet që datëlindja të hiqet nga certifikata meqë bëhet fjalë për të dhënë të ndjeshme sipas ligjit me nr. 03/L-172 të R. së Kosovës.

  (Afati kohor i këtyre kushteve: 01.10.2016)

1.4. Saldim, niveli 3 në KKK;

Akreditimi dhe validimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Rekomandohet kompletimi i kabinetit me pajisje për ekzaminim e lidhjeve të salduara-pajisja me ultratingull, penetrim.

  (Afati kohor i këtyre kushteve: 01.10.2016)

1.5. Instalues Elektrik, niveli 3 në KKK

Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:
Kushtet:

- Rekomandohet që gjatë orarit të punës i tërë stafi i Qendrës të mbajë të vendosura kartelat identifikuese në mënyrë që të dallohen nga kandidatët dhe palët e treta.
- QRAP nuk mund të publikojë informacione për Qendrën në uebsajt të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale. Rekomandohet që Qendra të kërkojë nga MPMS për ta menaxhuar/administruar një hapësirë në kuadër të faqes së MPMS nga ku do të mund të publikonte materiale të ndryshme.
- Në shumicën e rasteve, komunikimi i zyrtarëve të qendrës me organizata dhe persona të ndryshëm realizohet përmes postës elektronike private. Rekomandohet që stafi menaxhues dhe i tërë stafi i Qendrës të pajisen me e-postë (e-mail) zyrtare dhe komunikimi të kryhet përmes e-postave zyrtare.
- Rekomandohet që koordinatori për sigurimin e cilësisë të mbajë proces dhe të evidentojë takimet e zhvilluara me personelin e Qendrës për sigurimin dhe ngritjen e cilësisë dhe të kujdeset për të paralajmëruar menaxhmentin për datat e skadimit të përmbushjes së kritereve që kanë të bëjnë me cilësinë.
- Rekomandohet që Qendra të caktojë një përgjegjës i cili do të kujdesej dhe do të njoftonte menaxhmentin për afatet e skadimit për pajisjet a shërbimet me afat, siç janë aparatet kundër zjarrit, licencat e aplikacioneve të përdoruara, kutia e ndihmës së parë etj.
- Rekomandohet që dokumentacioni elektronik i Qendrës të ruhet në MPMS (jashtë ambientit të Qendrës) së paku një herë në muaj në mënyrë që të evitohen humbjet shumëvjeçare të të dhënave elektronike në rast të ndonjë fatkeqësie në objektin e Qendrës.
- Paketa mësimore e përdorur nga kandidatët në ambientet e Qendrës nuk mund të përdoret edhe në shtëpi. Nëse kandidatët dëshirojnë ta marrin paketën mësimore duhet ta fotokopjojnë me mjetet e veta financiare. Rekomandohet që paketa mësimore t'u jepet në shfrytëzim gjatë kohës së trajnimit ose të bëhet kërkesë nga MPMS që një kopje e paketës mësimore t'i falet secilit kandidat. Kjo do të ishte lehtësim për kandidatët kur kihet parasysh se ata janë punëkërkues.
- Nëse kandidati nuk e kalon testin final, atëherë nuk dihet cila është procedura për mundësinë e ri testimit. Rekomandohet që të ketë procedurë të shkruar për mënyrën e ri testimit.
- Përkundër faktit që kandidatëve u ofrohet edukim profesional në fushën e instalimeve elektrike, megjithatë mungon zinxhiri i komunikimit që nga momenti që kandidati largohet nga Qendra. Rekomandohet që të shtohet ky komunikim me qëllim të marrjes së

informatave kthyese dhe të vazhdohet kontakti me kandidatët deri në akomodimin e plotë të tyre.

- Gjatë kohës së trajnimit, kandidatët janë në nivele të ndryshme dhe është paksa e papërshtatshme që trajneri në të njëjtën orë të merret me grupe të ndryshme të kandidatëve. Kjo ndikon që edhe koha për një kandidat të jetë më e shkurtër. Rekomandohet që grupet të jenë sa më homogjene sa i përket modulit të cilin e ndjekin.
- Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit dhe në bazë të bisedave me menaxhmentin del se nuk ka procedurë për njohjen e kredive/moduleve. Rekomandohet që në bashkëpunim me MPMS dhe MASHT të zhvillohet një procedurë për njohjen e kredive.
- Tek formulari për validim të kualifikimit, numri i orëve praktike dhe teorike është me presje dhjetore. Rekomandohet që numri i orëve të jetë numër i plotë.
- Përkundër që ka politika të zhvilluara për zhvillimin dhe avancimin e stafit, një gjë e tillë nuk ka ndodhur që nga akreditimi i fundit. As trajneri i profilit Instalues Elektrik nuk ka përfituar ndonjë trajnim i cili do të kontribuonte për rritjen dhe përditësimin e njohurive të tij. Rekomandohet që trajneri të përditësojë njohuritë e tij duke ndjekur trajnime dhe seminare që lidhen me fushën e tij.
- Gjatë punës praktike me kandidatë, panelet të jenë të pajisura vetëm me materialin dhe veglat e njësisë modulare në mënyrë që të mos krijohet rrëmujë në panele.
- Panelet të jenë të organizuara në bazë të nivelit të kandidatëve dhe për kandidatët fillestarë paneli në fillim të jetë i zbrazur dhe pastaj të plotësohet në vazhdimësi.
- Në kabinet janë të montuara panelet e reja, por janë të montuara në një hapësirë të ngushtë dhe është paksa e vështirë dhe e rrezikshme për kandidatët të punojnë në një hapësirë të tillë. Rekomandohet që të bëhet riorganizimi i hapësirës ashtu që hapësira rreth paneleve të jetë më e përshtatshme.
- Vijueshmëria e kandidatëve të regjistrohet sikurse është duke u bërë edhe tash, por kandidatët të nënshkruhen vetë në listë dhe lista të jetë vetëm për një ditë, në mënyrë që kandidatët të mos kenë mundësinë të nënshkruhen edhe për ditët e mëparshme.
- Testi përfundimtar dhe testet modulare të jenë më të larmishme duke përfshirë edhe pyetje me përgjigje të shumëfishta dhe me rrumbullakim.
- Në varësi të përshkrimit të vendit të punës dhe në bazë të standardeve përkatëse dhe ligjeve në fuqi për mësimdhënie, rekomandohet që trajneri të ketë shkollim universitar.

Rekomandohet që menaxhmenti i Qendrës të hartojë një plan të qartë veprimi për realizimin e të gjitha rekomandimeve të cekura me lart përfshirë objektivat, aktivitetet, personelin e dedikuar dhe afatet kohore për realizimin e tyre. Ky rekomandim ka dalë si pasojë që qendra nuk i ka përmbushur rekomandimet e kaluara me përpikëri. (Afati kohor i këtyre kushteve: 01.10.2016)

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raportet e Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raportet e Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacionet për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacionet për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1 Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:

   - Qendrës për Aftësim Profesional Ferizaj;
   - AKK.

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOSOVO * AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE * NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY * NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE * REPUBLIKA KOSOVA *

Nën- Kryetari i KD së AKK-së
Anton Gojani